



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

E lidhur më datën: **19.02.2020** ndërmjet palëve kontraktuese:

Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson, **Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan**
z. Adem Duriqi në njërën anë (në tekstin e mëtejme) Autoriteti Kontraktues dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik **"Arhiko ing O.P" & "P.M.N"- Shpk** rruga B. Diellit, Z.
Lindjes, A11/13, **Prishtinë** të cilin e përfaqëson Shefshet Morina, **Drejtore** në vazhdim përdoret
(shkurtesa) Kontraktuesi

Titulli i kontratës: **"Hartimi i projekteve detale" me nr të prokurimit 613 019 010 211**

Lënda

Neni 1

1.1 Lënda e kontratës ka të bëjë me hartimin e projekteve kryesore (zbatuese) Arkitektonike, rrugëve, terene sportive, rregullimi i parterëve, ujësjellës, kanalizim, projekt kryesor për kolektor për ujra të zeza, ndriçimi publik, hartimi i projekteve për rregullim të shtratit të lumenjëve, të specifikuar në dosje të tenderit dhe pershkrim teknik.

1.2. Kontraktuesi obligohet me dispozitat e kësaj kontrate që t'i realizoj shërbimet e kërkuara të definuara si:

1.3 Ofrimi i shërbimeve projektuese me qëllim të hartimit të projekteve detale (investive) në komunën e Lipjanit – Kategoria e Projekteve : Planifikimi Urban, objektet shoqërorë me të gjitha fazat e nevojshme , arkitektura, statika elektrike, hidro , termo, etj), objekte ekonomike , objekte banimi (me të gjitha fazat e nevojshme , arkitektura, statika elektrike, hidro ,termo, etj), objekte të infrastrukturës (konstruksione) bazuar në dokumentin tenderues 613 019 010 211 i cili do t'i bashkangjitet Kontratës.

Neni 2

2.1. Kushtet e përgjithshme për procesin dhe hartimin e dokumentacionit tekniko-projektues për projektet do të jenë të prezentuara në detyrën programore-projektuese e cila do të jetë pjesë e dokumentit që do t' bashkangjitet Kontratës për secilin projekt për të cilin obligohet kontraktori që t'u përmbahet në teresi kushteve të parapara **dhe kontratës së veçantë e cila do të hartohet**

për secilin projekt ose edhe më shumë projekte të ngjashme nëse porosia është me një detyrë projektuese, për llojin dhe nivelin e projekteve nga fushat si vijon:

- I. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE URBANISTIK
- II. PROJEKTET KRYESORE DHE ZBATUESE PËR OBJEKTE SHOQËRORE, OBJEKTE BANIMI, OBJEKTET EKONOMIKE
- III. OBJEKTET E INFRASTRUKTURA
- IV. GJEODEZIA
- V. SHQYRTIMET GJEOMEKANIKE

2.2.Shërbimet e kërkuara – dokumentacioni teknik duhet të hartohet konform rregullativës ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit si: Ligji për Planifikim, Ligji për Ndërtim, Ligji për Rrugët, Ligji për VNM, Ujërat etj , varësisht nga kushtet që përcaktohen, lloji dhe niveli i projektit.

2.3.Kontrolla e Projektit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/06 si obligim i Kontraktorit.

Të gjitha Projektet dorëzohen **në 3 tri kopje analoge dhe digjitale**, dhe sipas nevojës edhe në gjuhët tjera zyrtare. Të gjitha projektet dhe projektet e fazave të ndryshme duhet të plotësojnë kushtet sipas “ISO” standardeve dhe normativave tjera të pranueshme me rregullativën ligjore. Bashkëpunimi me stafin e Drejtorateve komunale si DPU dhe dhe DSHP Drejtorinë e Prokurimit etj, është i obligueshëm.

2.4.Komuna mban të drejtën e porosisë për hartimin e projekteve sipas fazave të ndryshme, dhe në kushte të caktuara të cilat janë si pasojë e zhvillimeve aktuale dhe urgjente andaj duhet të merret parasysh nga ana e Kontraktuesit që të jetë në gjendje gadishmërie në çdo kohë varësisht nga natyra e punës që kërkohet në kuadër të shërbimeve.

2.5.Harmonizimi i procedurave për Leje ndërtimore, të cilat rezultojnë me harmonizimin e dokumentacionit teknik dhe dokumenteve tjera nga autoritetet nga niveli lokal dhe qendror – marrja e Pëlqimeve janë obligim i Drejtorisë përkatës e cila e ka parashtruar kërkesë për projekt dhe se çdo kërkesë plotësuese dhe shpenzimet tjera rreth procedurës me qëllim të kompletimit dhe kërkesave shtesë janë obligim i Autoriteti Kontraktues.

2.6. gjatë realizimit të projekteve kontraktuesi është i obliguar që të ofrojë sqarime sa herë që paraqitet ndonjë paqartësi në projekt.

2.7. Kontraktuesi duhet të ketë parasysh se gjatë punës parashifet pjesa e prezentimeve të fazave të caktuara të punës me qëllim të zhvillimit shqyrtimeve publike me pjesëmarrësit në këtë projekt – debati publik me qëllim të finalizimit të Projekteve, transparent dhe në nivel të duhur.

Menaxhimi i Projektit

Neni 3

3.1.Me qëllim të koordinimit të punëve si bartës i detyrës për menagjim caktohet **Hanushe Berisha**

Detyrtat dhe obligimet e menaxherit

3.2. Të bashkëpunojnë me projektuesin rreth hartimit të Projekteve Kryesor, të krahasoj Projektin me Ofertën e kontraktuesit dhe specifikimet teknike të caktuara në dosjen e e projekteve të specifikuara nga autoriteti kontraktues.

3.3. Në rast se menaxheri i projektit vëren ndonjë defekt në projekt menjëherë sa më shpejt që është e mundur dhe pa humbur kohë do të kërkojë me shkrim nga kontraktuesi eliminimin e defekteve.

Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga menaxheri i projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

3.4. Të kujdeset për pagesën e shumës së kontraktuar të kontraktuesit.

3.5. Të përgadis raportin me shkrim mbi realizimin e hartimit të projektit Kryesor dhe të njëjtin ta dërgoj në Sektorin e Prokurimit për pagesë.

3.6 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

3.6 Autoriteti kontraktuesi do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin të kontratës për atë projekt.

Çmimi i shërbimeve

Neni 4

4.1 Çmimi i shërbimeve për projektin do të llogariten në bazë të ofertës së Kontraktuesit të ofruara në dosjen e tenderit: Ofrimi i shërbimeve projektuese me qëllim të hartimit dhe implementimit të projekteve investive në komunën e Lipjanit – Kategoria e Projekteve : Infrastrukturë teknike,

bazuar në dokumentin tenderues 613 019 010 211 i cili do t'i bashkangjitet Kontratës çmimet e kontraktuesit do ti bashkëngjiten kontratës dhe do të jenë bazë për çdo hartim të projekteve për të cilat ka arrit kërkesa.

4.2 Pagesa për projektet e caktuara do të përcaktohet në bazë të çmimeve për njësi të ofruar nga kontraktuesi për hartim të çdo projekti që kërkon autoriteti kontraktues, por jo më larg se 30 ditë pasi të jenë plotësuar kushtet për pagesë.

Afati

Neni 5

5.1 Kjo kontratë lidhet në kohëzgjatje prej 3 viteve nga data e nënshkrimit të kontratës 19.02.2020 deri më 19.02.2023.

5.2 Projektuesi obligohet që dokumentacionin tekniko projektues ta kryej sipas afateve të ofertuara në ofertë e cila do të jetë bazë edhe për kohëzgjatjen e projektit konkret për të cilin është kërkuar projekti.

5.3 Afatet për realizimin e projekteve do të caktohen me detyrën projektuese për secilin projekt të porositur, dhe në bazë të kontratës së veçantë për projektet konkrete.

Intuite persona

Neni 6

6.1 Projektuesi obligohet që tërë Dokumentacionin projektues ta kryej vet dhe nënkontraktorëve të paraqitur në dosje të tenderit nuk ka të drejtë të ia besoj kryerjen e shërbimeve personave tjerë, pa pëlqimin e autoritetit kontraktues.

Obligimet e posaçme të projektuesit

Neni 7

7.1. Projektuesi obligohet që ta hartoi projektin kryesor –zbatues të kontraktuar sipas detyrave projektuese si dhe t'i përmbahet vërejtjeve të dhëna nga menagjeri i kësaj kontrate dhe organeve kompetente.

7.2. Projektuesi obligohet që të paguaj sigurimin e ekzekutimit në shumën prej 10,000.00€ në kohëzgjatje prej 13 muajve për çdo vit.

Përmbushja e Kontratës në afatin e caktuar

Neni 8

8.1 Kontraktuesi duhet të fillojë aktivitetin për kryerjen e hartimeve të projekteve pas pranimit të kërkesës me detyrë projektuese nga menaxheri i kontratës dhe t'i përfundojë ato në afatin e caktuar për përmbushje të kontratës.

8.2 Kontraktuesi është i autorizuar që t'i kryejë shërbimet e hartimit të projekteve në përputhje me projektin kryesor i cili është bazë e projektit ideor.

8.3 Në qoftë se kontraktuesi nuk i kryen shërbimet e hartimit të projekteve në përputhje të plotë me projektin e aprovuar ideor ose substancialisht i kryen shërbimet ndryshe nga projekti kryesor, do të përgjigjet për përmbushje të parregullt të kontratës dhe/ose për kundërvajtje ekonomike.

8.4 Nëse projektuesi e harton projektin me gabime që në ekzekutim do të ndryshojë më shumë se 20% nga vlera e kontratës për atë projekt, Projektuesi do t'i mbulojë shpenzimet e ekzekutimit për punët e kryera nga gabimet e veta me sigurim përkatës.

8.5 Kontraktuesi do të fillojë shërbimet për projektet në fjalë vetëm pasi të pranojë kërkesën me shkrim për projektin konkret nga ana e drejtorisë për planifikim dhe urbanizëm dhe të hartojë atë sipas detyrës projektuese të përcaktuar.

Zgjatja e afatit për përmbushje të kontratës

Neni 9

9.1 Menaxheri për përcjelljen e hartimit të projekteve i caktuar nga Autoriteti kontraktues, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues do të lejojë zgjatjen e afatit të përmbushjes së kontratës në qoftë se paraqiten punë urgjente dhe të paparapara ose rrethana tjera të cilat pamundësojnë kryerjen e projektit të kontraktuar në afatin e caktuar.

Penalitetet për të metat

Neni 10

10.1 Kontraktuesi do t'i paguajë Autoritetit kontraktues për çdo ditë vonese duke llogaritur nga data e caktuar në kontratë për përfundimin e projektit e deri në ditën kur kontraktuesi njofton me shkrim menaxherin e projektit për përfundimin e projektit.

10.2 Shuma totale e penaliteteve për të metat nuk mund të tejkalojë totalin e shumës së përcaktuar në kontratë.

10.3 Pagesa e penaliteteve nuk do të ndikojë në obligimet e kontraktuesit.

10.4 Nëse kontraktuesi me fajin e tij nuk e kryen shërbimin në afatin e kontraktuar, ndaj tij do të aplikohen penalet në vlerë prej 0.2% të vlerës së përgjithshme të projektit, për çdo ditë vonese.

Të drejtat autoriale të projektuesit

Neni 11

11.1 Palët kontraktuese pajtohen që porositësi nuk do ta shfrytëzoj Dokumentacionin projektues për të punuar edhe për projekte të tjera, por vetëm për projektin kontraktues.

11.2 Porositësi obligohet që në vend të dukshëm të Projektit të theksoi emrin dhe Ndërmarrjen që ka bërë projektimin e projektit zbatues (dokumentacionin teknik – projektues, për projektin i cili është kontraktuar dhe për këtë obligohet Autoriteti Kontraktues të mos e ndryshoj Dokumentacionin e projektuar.

Shikimi i dokumentacionit

Neni 12

12.1 Palët kontraktuese janë pajtuar që porositësi pas pranimit të dokumentacionit (projektit) ta shikoj dokumentacionin teknik të projektuar dhe që në afat prej 5 ditëve pune ta njoftoj Projektuesin mbi vërejtjet eventuale, ndërsa Projektuesi obligohet që në afat maksimal prej 10 ditësh të veproj në bazë të vërejtjeve të dhëna të porositësit.

Shkëputja e kontratës

Neni 13

13.1 Kontrata mund të shkëputet me vullnetin e njëres palë kontraktuese për shkak të shkeljeve materiale të kontratës, në rastet si në vijim:

- (a) Kontraktuesi nuk i përmbahet planit dinamik për hartim të projekteve sipas kërkeses të Autoritetit Kontraktues për të cilën lidhet kontratë e veçantë ;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e projekteve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune;
- (c) Pala tjetër kontraktuese falimenton apo hyn në likuidim, përveç me përjashtim të rastit të riorganizimit apo shkrirjes;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga punëdhënësi brenda 30 ditësh nga dita kur është vërtetuar pagesa në fjalë;
- (e) Menaxheri i projektit në njoftimin me shkrim që i bënë punëmarrësit mbi evitimin e defekteve, e njofton edhe mbi atë se mos evitimi i defekteve paraqet shkelje bazë të kontratës, megjithatë punëmarrësi nuk ndërmerr masat e nevojshme paraprake për evitimin e defekteve, kështu që dështon në korrigjimin e defekteve brenda 30 ditë pune që përcaktohet nga menaxheri i projektit të Punëdhënësit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e defekteve mund të paguhet;

Ndryshimi në sasi të punëve të përfunduara

Neni 14

14.1 Në qoftë se pas llogaritjes së punëve të përfunduara, Menaxheri i Projektit vëren ndryshime në mes të sasisë së punëve të përfunduara dhe sasisë së punëve të kontraktuara për shkak të paraqitjes së rrethanave apo punëve urgjente të paparapara, atëherë do të rregulloj situatën në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

14.2 Nëse sasia e punëve të përfunduara dallon nga sasia në faturën e sasisë për artikull të veçantë për më tepër se 25%, paraqitet ndryshim që e tejkalon 1% por nuk e tejkalon 10% të çmimit fillestar të kontratës, menaxheri i Projektit do të harmonizojë shkallën për të lejuar ndryshimin.

14.3 Në qoftë se çmimi i kalkuluar për punët e përfunduara tejkalon 10% të çmimit fillestar të kontratës, atëherë punëdhënësi nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit fillestar të kontratës, por do ta udhëzojë menaxherin e Projektit të kalkulojë vetëm punët e paparapara për të cilat do të lidhej një aneks-kontratë midis palëve të kontratës kryesore në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik.

Zgjidhja e kontesteve

Neni 15


15.1. Palët kontraktuese pajtohen që kontestet eventuale që lindin me rastin e mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga kjo kontratë t'i zgjedhin me mirëkuptim e në rast të mos pajtimit çështja të kalojë për vendosje në Gjykatën ekonomike të Kosovës.

Neni 16

16.1. Kjo kontratë është hartuar në katër (4) kopje identike, ku nga një kopje u jepet palave kontraktuese kurse dy të tjerat mbahen në dosje të tenderit

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Shefshet Morina
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data		Data:	19.02.2020
Vula:		Vula:	



Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Imri Ahmeti
Pozita:	Kryetar i Komunës
Nënshkrimi:	
Data:	19.02.2020
Vula:	



Formulari i përshkrimit të çmimeve

Paramasa për projektme të kanalizimeve, rrugëve, ujësjellësve, plane zhvillimore- urbane në Komunën e Lipjanit

Hartimi i projekteve detale						A
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma	
A	Hartimi i projekteve Konceptuale dhe Ideore (Objekte Banimi, Administrative, Shkollore, Shoqërore, Sportive, Shëndetësore, Ekonomike, Kulturore etj). duke e përfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.					
1	Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m ²	1	0.01	0.01	
2	Punimi i projektit ideor – Rregullimi i partereve -duke përfshi edhe incizimin e gjendjes ne teren,	m ²	1	0.01	0.01	
A	TOTALI :{1 deri 2}				0.02	
B						
B	Hartimi i projekteve Kryesore dhe zbatuese (Objekte Banimi, Administrative, Shkollore, Shoqërore, Sportive, Shëndetësore, Ekonomike, Kulturore etj) duke e përfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.					
1	Punimi i projektit kryesor - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit	m ²	1	0.01	0.01	
2	Punimi i projektit kryesor - Statika konstruksioni dhe stabiliteti i objektit	m ²	1	0.01	0.01	
3	Punimi i projektit kryesor të Hidroinstalimeve	m ²	1	0.01	0.01	
4	Punimi i projektit kryesor Instalimet Elektrike	m ²	1	0.01	0.01	
5	Punimi i projektit kryesor të instalimeve Makinerike	m ²	1	0.01	0.01	
6	Punimi i projektit kryesor të masave mbrojtëse për siguri të objektit, masat kundër zjarrit.	m ²	1	0.01	0.01	
7	Projektimi i Enterierit	m ²	1	0.01	0.01	
8	Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE. / duke përfshire edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.	m ²	1	0.01	0.01	
B	TOTALI :{1 deri 7}				0.08	
TOTALI (A+B) :					0.10	

C					
C	Hartimi i projekteve Kryesore -zbatues per objekte ekzistuese - Renovime, nderhyrje, rikonstruime, sanime etj (Objekte Banimi, Administrative, Shkollore, Shoqërore, Sportive, Shëndetësore, Ekonomike, Kulturore etj). duke e perfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.				
1	Incizimi i objekteve ekzistuese (ARKITEKTURA), dhe përpilimi i projektit arkitektonik për objektet ekzistuese.	m ²	1	0.01	0.01
2	Incizimi i objekteve ekzistuese-STATIKA, dhe përpilimi i projektit te Statikes për objektet egzistuese.	m ²	1	0.01	0.01
3	Incizimi i objekteve ekzistuese-ELEKTRIKA, dhe përpilimi i projektit te ELEktrikes për objektet egzistuese .	m ²	1	0.01	0.01
4	Incizimi i objekteve ekzistuese-MAKINERIA, dhe përpilimi i projektit te Makinerise për objektet egzistuese.	m2	1	0.01	0.01
5	Incizimi i objekteve ekzistuese-UJESJELLESI DHE KANALIZIMI, dhe përpilimi i projektit te (Ujesjellesi&Kanalizimi) për objektet egzistuese.	m2	1	0.01	0.01
C	TOTALI :{1 deri 5}				0.05
	TOTALI (C) :				0.05

E					
E	<i>Hartimi i projekteve për Rrugë dhe objektet e rruges - duke perfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.</i>				
1	Projektim i rrugëve me 1 dhe 2 Korsi	m'	1	0.44	0.44
2	Projektim i rrugëve me 3 Korsi	m'	1	0.01	0.01
3	Projektim i rrugëve me 4 Korsi	m'	1	0.01	0.01
4	Projektimi i Urave deri 10 m	m'	1	0.01	0.01
5	Projektimi i Urave mbi 10 m	m'	1	0.01	0.01
6	Projektimi i sinjalizimit te rrugëve	m'	1	0.01	0.01
7	Projektimi për rregullimin e nyjeve te komunikacionit	m ²	1	0.01	0.01
E	TOTALI (1 deri 7) :				0.50

F					
F	<i>Hartimi i projekteve Kryesore -zbatuese për Trajtim te Ujerave - duke perfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.</i>				
1	Projektimi i Kanalizimit Fekal	m'	1	0.01	0.01
2	Projektimi i Kanalizimit Atmosferik	m'	1	0.01	0.01
3	Projektimi i Rrjetit te Ujësellsit	m'	1	0.01	0.01
4	Projektimi I rrjetit te telefonise, internet etj .	m'	1	0.01	0.01
5	Projektimi i shtratit të perroit / lumenjeve	m'	1	0.01	0.01
6	Projektimi i impianteve per trajtimin e ujerave	m³	1	0.01	0.01
7	Projektimi i Rezervoarve - te Ujit	m³	1	0.01	0.01
F	TOTALI (1 deri 7) :				0.07
	TOTALI (E+F) :				0.57

G					
G	<i>Hartimi i projekteve kryesore -zbatuese për Rrjetet Elektrike, Nriqimet Publike, Muret mbrojtese, trotualet - duke perfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.</i>				
1	Projektimi i trotuareve	m'	1	5.50	5.50
2	Projektimi i rrjetit elektrike dhe ndriçimit publik Nentoksor apo mbitoksor.	m'	1	2.50	2.50
3	Projektimi i Mureve Mbrojtëse	m'	1	0.01	0.01
4	Projektimi i shtigjeve per bicikleta	m'	1	0.01	0.01
G	TOTALI (1 deri 4) :				8.02

D					
D	<i>Hartimi i projekteve kryesore -zbatuese për hapësira të hapura publike - Terene të hapura - duke përfshirë edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.</i>				
1	Projektimi i tereneve sportive - të hapura	m ²	1	0.01	0.01
2	Projektimi i shesheve	m ²	1	0.01	0.01
3	Projektimi i parqeve, kendeve për fëmijë etj.	m ²	1	0.01	0.01
4	Projektimi i venparkingjeve	m ²	1	0.01	0.01
D	TOTALI (1 deri 4) :				0.04
	TOTALI (G+D) :				8.06

H					
H	<i>Punimi i Elaborateve për nevojat e Autoritetit Kontraktues</i>				
1	Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik.	m'	1	0.01	0.01
2	Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik.	m ²	1	0.01	0.01
3	Hartimi i Elaboratit për Matje gjeodezike , inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike në baze të kërkesës së AK për sipërfaqet apo m' për nevojat konkrete	m'	1	0.01	0.01
4	Hartimi i Elaboratit për Matje gjeodezike , inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike në baze të kërkesës së AK për sipërfaqet apo m' për nevojat konkrete	m ²	1	0.01	0.01
H	TOTALI (1 deri 4) :				0.04
	TOTALI (H) :				0.04
	TOTALI I PERGJITHSHEM				8.82€